



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2164/24 prot

Datë 05.05.2026

V E N D I M
Nr. 590/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1181/2025, datë 03.09.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj. Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Cara” SHPK me NUIS K07729920F dhe adresë: Lagjja “Pjetër Budi”, Rruga “Abdi Mati”, Ndërtesë private Nr.10, Mat.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tropojë me adresë: Sheshi “Azem Hajdari”, Qyteti Bajram Curri

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1181/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj.Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Cara ” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2404 prot., date 24.04.2026 me objekt: “Kërkesë për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit”, protokolluar me tonën nr. 2164/22 prot., datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë, kërkon si vijon:

“Bashkia Tropojë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ju drejtohet me anë të kësaj shkrese për të kërkuar heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj.Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, e cila aktualisht ndodhet në fazë pezullimi pranë jush.

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe akteve nënligjore në fuqi, autoriteti kontraktor vlerëson se ekzistojnë shkaqe objektive për anulimin e kësaj procedure. Konkretisht, referuar nenit 98 të këtij ligji (Anulimi i procedurës së prokurimit), parashikohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të anulojë procedurën kur nuk është e mundur sigurimi i fondeve të nevojshme për realizimin e saj.

Në rastin konkret, si pasojë e zvarritjes së procedurës dhe pamundësisë për të përdorur fondin brenda afateve buxhetore, autoriteti kontraktor ndodhet në kushtet e mungesës së fondeve, cka e bën të pamundur vijimin e mëtejshëm të procedurës.

Për sa më sipër dhe duke qënë se procedura rezulton aktualisht e pezulluar, është e nevojshme heqja e pezullimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim që autoriteti kontraktor të ushtrojë të drejtën ligjore për anulimin e procedurës, në përputhje me nenin 98 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në këto kushte, kërkohet nga ana juaj shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe marrjen e vendimit për heqjen e pezullimit të procedurës së sipërcituar, në mënyrë që të vijojmë me procedurat përkatëse për anulimin e saj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.2404 prot., date 24.04.2026 me objekt: “Kërkesë për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit”, protokolluar me tonën nr. 2164/22 prot., datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë, kërkon si vijon:

“Bashkia Tropojë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ju drejtohet me anë të kësaj shkrese për të kërkuar heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj.Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, e cila aktualisht ndodhet në fazë pezullimi pranë jush.

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe akteve nënligjore në fuqi, autoriteti kontraktor vlerëson se ekzistojnë shkaqe objektive për anulimin e kësaj procedure. Konkretisht, referuar nenit 98 të këtij ligji (Anulimi i procedurës së prokurimit), parashikohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të anulojë procedurën kur nuk është e mundur sigurimi i fondeve të nevojshme për realizimin e saj.

Në rastin konkret, si pasojë e zvarritjes së procedurës dhe pamundësisë për të përdorur fondin brenda afateve buxhetore, autoriteti kontraktor ndodhet në kushtet e mungesës së fondeve, cka e bën të pamundur vijimin e mëtejshëm të procedurës.

Për sa më sipër dhe duke qënë se procedura rezulton aktualisht e pezulluar, është e nevojshme heqja e pezullimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim që autoriteti kontraktor të ushtrojë të drejtën ligjore për anulimin e procedurës, në përputhje me nenin 98 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në këto kushte, kërkohet nga ana juaj shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe marrjen e vendimit për heqjen e pezullimit të procedurës së sipërcituar, në mënyrë që të vijojmë me procedurat përkatëse për anulimin e saj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.”

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1181/2025, datë 03.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE dhe e ka skualifikuar shoqërinë “Cara” SHPK për arsyen e mëposhtme:

“Puna e ngjashme paraqitur nga OE nuk plotëson kriterin sepse nese llogariten zerat e ngjashem, nuk e arrijne vleren 50% te kontrates tone te kerkuar nga Njesia e Prokurimit ne DST”

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në veprimet procedurale të autoritetit kontraktor lidhur me këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, me vendimin nr.1181/2025, datë 03.09.2025, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe është urdhëruar autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim

Rezulton se, autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e ankimuesit sa i përket ofertës ekonomike, por ka vijuar me skualifikimin e ankimuesit për arsye të tjera skualifikimi, duke bërë rivlerësimin e ofertës së tij, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura, autoritetet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me rigorozitet vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe të kryejnë rivlerësimin e ofertave konform konstatimeve të pasqyruara në këto vendime, ndërkohë që operatorët ekonomikë të cilët gjykojnë se interesat e tyre të ligjshme janë prekur nga këto procedura rivlerësimi, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre, gjithnjë duke mbajtur në konsideratë afatet ligjore të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi.

Si konkluzion, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se në rastin konkret, referuar argumentimit si më sipër, autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë duhet të marrë masat për korrigjimin e situatës, duke kryer rivlerësimin e procedurës mbështetur ekskluzivisht në vendimin nr.1181/2025, datë 03.09.2025, pra Autoriteti kontraktor duhet të zbatojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe të vërë në dijeni për zbatimin e këtij vendimi.

Kryerja e hapave të tjerë proceduriale është e mundur pasi Komisioni i Prokurimit Publik të ketë marrë dijeni për zbatimin e vendimit dhe të vendosë heqjen e pezullimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr. REF-52709-06-27-2025, me objekt: “Ndërtim Rruga Auto Kika –Gj. Dragobisë–Qafë Pajë”, me fond limit 82,911,061.31 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 15.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 1181/2025, datë 03.09.2025 të KPP-së.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

